

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Nr 1.Tiranë

PROGRAMI

I KURSIT TË VEÇANTË

“MONTIM DHE MIRËMBAJTJE ASHENSORI ”

KODI: MMA-20

Miratoi

DREJTOR

.....

Tiranë, 2020

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“Montim dhe mirëmbajtje ashensori ”

(MMA-20)

I. Profili Profesional I MONTUESIT DHE MIRËMBAJTËSIT TË ASHENSORIT.

a) Karakteristikat e Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit.

Montuesi dhe mirëmbajtësi i ashensorit është i aftë të **kryejë detyra** profesionale si i punësuar në kompani të ndryshme të cilat kryejnë montimin, mirëmbajtjen e ashensorëve dhe shkallëve vetëlëvizëse.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, Montuesi dhe mirëmbajtësi i ashensorit duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe **shprehje** profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit.

Suksesi i Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: shkathhtësia, qetësia, kujdesi, përqendrimi, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit .

Profesioni Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës që kryen në montim dhe mirëmbajtje të ashensorit dhe shkallëve vetëlëvizëse. Specialisti montator i ka të gjitha mundësitë për të përparuar në profesion. Nëpërmjet kualifikimit të mëtijshëm apo trajnimit nëpërmjet punës duke kaluar në proceset e montimit, studimin e përvetësimit e vazhdueshëm të pjesës teorike e praktike të këtij profesioni, ai mund të hapi një biznes të vetin për montimin e ashensorëve, ose mirëmbajtjen e tyre. Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Montues dhe mirëmbajtës ashensori”, me kod 7224.01, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Montim dhe mirëmbajtje ashensori”.

Në përfundim të Kursit për “**Montim dhe mirëmbajtje ashensori**”, kursantët do të jenë të aftë të:

- përdorin skema dhe skica “tip “ të ashensorëve që do të montojnë;
- kryejnë kontrollin për kërkesat teknike të ambjentit të montimit;
- mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe mjedisin e punës;
- kryejnë matje teknike;
- kryejnë skema të montimit të ashensorit;
- kryejnë montimin e shinave të ashensorit;
- kryejnë montimin e cilindrave hidralike të ashensorit hidraulik;
- kryejnë montimin e dyerve të ashensorit;
- kryejnë montimin e platformës së ashensorit;
- kryejnë montimin e gabinës së ashensorit;
- kryejnë montimin e platformes levizëse;
- kryejnë montimin e kavove dhe kundrapeshat e ashensorit;
- kryejnë montimin e dyerve të kateve të ashensorit;

- kryejnë montimin e pjesëve elektrike të ashensorit;
- kryejnë montimin dhe lidhin pjesët elektrike në rrjet;
- kryejnë montimit e ashensorit;
- kryejnë montimin e shkallëve vetëlëvizëse;
- kryejnë komandimin automatik ashensorit;
- kryejnë kolaudimin mekanik dhe përfundimtar të ashensorit dhe shkallëve vetëlëvizëse;
- riparojnë defektet e mundëshme të ashensorit dhe shkallëve vetëlëvizëse;
- mirëmbajnë ashensorët dhe shkallët vetëlëvizëse;
- zbatojnë standardet për montimit e ashensorit;
- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- zbatojnë legjislacionit dhe kodin e punës;
- komunikojnë me etikë profesionale.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Montim dhe mirëmbajtje ashensori”.

Pjesëmarrësit në Kursin për “**Montim dhe mirëmbajtje ashensori**” duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të kenë kualifikime ose përvojë pune si mekanik.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Montim dhe mirëmbajtje ashensori”.

320 orë mësimore,
ku 1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Montim dhe mirëmbajtje ashensori”.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit.	MMA-01-20	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan profesionin e Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit. 2. Kursanti përshkruan veçoritë e makinerive dhe paisjeve ngritëse transportuese. 3. Kursanti përshkruan ashensorët dhe shkallët vetëlëvizëse. 4. Kursanti dallon veglat, pajisjet dhe materialet për instalimin e ashensoreve. 5. Kursanti përshkruan rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit në montimin dhe mirëmbajtjen e ashensoreve
2	Ndërtimi i ashensorit elektrik, hidraulik dhe shkallëve vetëlëvizëse.	MMA-02-20	20 orë mësimore Rekomandohet: 60% Teori 30% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan pjesët kryesore të ashensorit mekanik dhe hidraulik . 2. Kursanti përshkruan skemën e lëvizjes dhe frenimit të ashensorit. 3. Kursanti përshkruan parametrat teknike të shkallëve vetëlëvizëse. 4. Kursanti ndërton skemën e montimit të ashensorit dhe kryen montimin e tij.

3	Montimi mekanik i ashensorit.	MMA-03-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti monton udhëzuesin e kabinës dhe kundrapeshave. 2. Kursanti monton sistemin e fuqisë që vë në lëvizje ashensorin dhe shkallën vetëlëvizëse. 3. Kursanti monton platformën lëvizëse. 4. Kursanti monton dyert e kateve dhe kabinës së ashensorit.
4	Montimi i paisjeve elektrike të dhe elektronike ashensorit.	MMA-04-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë mbi elektricitetin dhe paisjet elektrike në përbërjen e ashensorit. 2. Kursanti përshkruan veçoritë e elektronikës, dhe parametrat bazë të matjeve elektrike. 3. Kursanti kryen lidhjet e paisjeve elektrike në kabinë dhe në ashensorin inverter. 4. Kursanti monton elementet e sigurisë së ashensorit. 5. Kursanti vendos në punë manualisht ashensorin.
5	Montimi i shkallëve vetëlëvizëse.	MMA-05-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti monton konstruksionin e shkallëve vetëlëvizëse. 2. Kursanti monton grupin e fuqisë dhe sistemin e komandimit (koromanos) të shkallëve vetëlëvizëse. 3. Kursanti e monton elementët e sigurisë të shkallëve vetëlëvizëse.
6	Sistemi i komandimit automatik.	MMA-06-20	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen programimin e komandimit automatik të ashensorit dhe shkallëve vetëlëvizëse. 2. Kursanti përdor programimin e sistemit të komandimit dhe kontrollit automatik të ashensorit.
7	Kolaudimi mekanik i ashensorit dhe shkallëve vetëlëvizëse.	MMA-07-20	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen kolaudimin përfundimtar të ashensorit dhe parametrave të punës së ashensorit . 2. Kursanti ploteson dokumentacionin e kërkesave teknike të montimit së ashensorit. 3. Kursanti ploteson dokumentacionin për certifikimin dhe administrimin e ashensorëve dhe shkallëve vetëlëvizëse.

8	Riparimi i defekteve të ashensorit, shkallëve vetëlëvizëse dhe mirembajtja e tyre.	MMA-08-20	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti diagnostikon defektet gjatë punës së ashensorit dhe shkallëve vetëlëvizëse. 2. Kursanti kryen riparimin e defekteve në ashensore dhe shkallët vetëlëvizëse. 3. Kursanti harton kontratat për mirëmbajtjen e ashensorëve dhe shkallëve vetëlëvizëse. 4. Kursanti ndërton grafikun e shërbimeve që i kryen ashensorit dhe shkallëve vetëlëvizëse.
----------	--	------------------	--	--

VI. Vlerësimi dhe Certifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Montim dhe mirëmbajtje ashensori”

1. Moduli “Hyrje në profesionin e “Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit ”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kod	HYRJE NË PROFESIONIN E MONTUESIT DHE MIRËMBAJTËSIT TË ASHENSORIT	MMA-01-20
Qëllimi i modulit	Nje modul teorik që i njeh kursantët me ndërtimin dhe funksionimin e ashensorit dhe shkallëve vetëlëvizëse, me mjetet dhe materialet e punës si dhe me rregullat e sigurisë në punë.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan profesionin e montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit . Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë historikun, qëllimin dhe rendësinë e shërbimeve; - të përshkruajë funksionet dhe detyrat kryesore të montuesit dhe mirëmbajtësit ashensori; - të përshkruajë mjedisin, vendin dhe kushtet e punës të organizimit të punës së montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorëve; - të përshkruajë paisjet, mjetet dhe veglat e punës; - të mirëmbajë pajisjet, mjetet dhe veglat e punës; - të përshkruajë karrierën profesionale të montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorëve. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Pyetje - përgjigje me shkrim. RM 2 Kursanti përshkruan veçoritë e makinerive dhe paisjeve ngritëse transportuese . Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë llojet e makinerive dhe paisjeve ngritëse transportuese, karakteristikat e tyre; - të përshkruajë vincat dhe transportiret, fushat e përdorimit të tyre; - të përshkruajë transportin me teleferik; - të përshkruajë fushat e përdorimit të ashensorëve; - të përshkruajë shkallët dhe tapetet vetëlëvizëse fusha e përdorimit të tyre. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë.	

- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan ashensorët dhe shkallët vetëlëvizëse.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet e ashensorëve dhe shkallëve vetëlëvizëse;
- të tregojë klasifikimin e ashensorëve dhe shkallëve vetëlëvizëse;
- të përshkruajë ashensorët në forme karike dhe në formë shale;
- të përshkruajë ambjentet e instalimeve të ashensorëve dhe shkallëve vetëlëvizëse.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 4 Kursanti dallon veglat, pajisjet dhe materialet për instalimin e ashensoreve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të dallojë dhe përshkruajë veglat e punës për montimin e ashensorit ;
- të dallojë dhe përshkruajë pajisjet e punës montimin e ashensorit dhe shkallëve vetëlëvizëse;
- të dallojë dhe përshkruajë materialet e punës për montimin e ashensorit dhe shkallëve vetëlëvizës;
- të klasifikojë armaturat sipas grupeve përkatëse;
- të shpjegojë funksionin e armaturave sipas grupeve;
- të përshkruajë aksesoret e montimit dhe fiksimit të ashensorëve;
- të përshkruajë veglat matëse që përdoren gjatë montimit të ashensorëve;
- të përshkruajë veglat dhe instrumentet e punës që përdoren gjatë montimit të ashensorëve;
- të mirëmbajë veglat dhe instrumentet e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 5 Kursanti përshkruan rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit në montimin dhe mirëmbajtjen e ashensorëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë uniformën e duhur përpara fillimit të punës;
- të përzgjedhë mjetet dhe masat mbrojtëse gjatë montimit të ashensorit;
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik në punë;
- të përshkruajë rregullat për punën në lartësi;
- të përshkruajë rregullat për mbrojtjen nga zjarri;
- të përshkruajë rregullat për mbrojtjen nga rryma elektrike;
- të përshkruajë demonstrojë veprimet për dhënien e

- ndihmës së parë për të dëmtuarit gjatë punës;
- të përshkruajë rregullat për ruajtjen e mjedisit gjatë montimit të ashensorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe mjediset e punës së repartit të Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit. - Rekomandohen dhe vizita ose praktika në biznese që kryejnë veprimtari të Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin e Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit. - Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha - kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës, ose kabinet për realizimin e kursit. - Kompleti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në kabinetin e Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit . - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Ndërtimi i ashensorit elektrik, hidraulik dhe shkallëve vetëlëvizëse.”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	NDËRTIMI I ASHENSORIT ELEKTRIK, HIDRAULIK DHE SHKALLËVE VETËLËVIZËSE.	MMA-02-20
Qëllimi i modulit	Një modul që njeh kursantët me veçoritë e pjesëve ndërtuese të ashensorit elektrik, ashensorit hidraulik, shkallëve vetëlëvizëse si dhe me skemën e lëvizjes dhe frenimit të ashensorit.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 60% Teori; 30% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer Modulin “Hyrje në profesionin e Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan pjesët kryesore të ashensorit mekanik dhe hidraulik. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë pjesët kryesore të ashensorit; - të përshkruajë dhomën e makinerisë, karakteristikat dhe pjesët përbërëse të saj; - të përshkruajë agregatin e vënies në levizje të ashensorit, llojet, pjesët përbërëse të tij; - të përshkruajë karakteristikat e udhëzuesëve të kabinës së ashensorit; - të tregojë udhëzuesin e kondrapeshave të ashensorit; - të përshkruajë veçoritë konstruktive të litarëve që përdoren te ashensorët ; - të përshkruajë ndertimin e kabinës së ashensorit konstruksionin i tij; - të përzgjedhë materialet dhe të përmbush kërkesa teknike të kabinës në prodhim dhe montim; - të përshkruajë funksionimin e ashensorit hidraulik, fushat e përdorimit të tij; - të tregojë elementët kryesorë në përbërjen e ashensorit hidraulik. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Pyetje - përgjigje me shkrim. RM 2 Kursanti përshkruan skemën e lëvizjes dhe frenimit të ashensorit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë matjet teknike;	

- të përshkruajë skema të ndryshme të përdorimit në funksionimin e ashensorëve;
- të përshkruajë elementët që marin pjesë në ashensor dhe demostrojë mënyrat e transmetimit të tyre;
- të përshkruajë elementët e sigurisë të frenimi i zakonshëm dhe frenat e emergjencës;
- të përshkruajë llojet dhe ndërtimin e amortizatorëve;
- të kontrollojë amortizatorët e vendosur në pusin (fundin) e ashensorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan parametrat teknike të shkallëve vetëlëvizëse.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë mënyrën e funksionimit të shkallëve vetëlëvizëse, fusha e përdorimit të saj;
- të tregojë parimet e punës të shkallëve vetëlëvizëse;
- të përshkruajë elementët baze të tapeteve dhe shkallëve vetëlëvizëse;
- të përshkruajë llojet e shkallëve vetëlëvizëse dhe parametra teknike të tyre;
- të përshkruajë mënyrat e prodhimit dhe të transportit të shkallëve vetëlëvizëse - aksesore ndihmës;
- të përshkruajë konstruksionin metalik dhe shkallaret e një shkalle vetëlëvizëse;
- të përshkruajë udhëzuesit e zinxhirëve, të shkallareve të shkallës vetëlëvizëse –mënyrat e montimit të tyre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 4 Kursanti ndërton skemën e montimit të ashensorit dhe kryen montimin e tij.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë procedurat për montimin e ashensorit;
- të përzgjedhë veglat paisjet dhe materialet për montimin e ashensorit;
- të ndertojë skemën e montimit të ashensorit hap pas hapi;
- të kryejë ngritjen e skelave praktikisht në të gjithë gjatësinë e pusit ku do të montohet ashensori;
- të kryejë hedhjen e përmasave të skices në planin e pusit dhe shënimi i tyre në tavanin e tij;
- të kryejë montimin e traversave ndihmëse për lëshimin e plumçeve sipas bllok skemës;

- të kryejë lëshimin e plumçeve dhe kontrollin e pusit për plotësimin e kërkesave teknike të montimit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe mjediset e punës së repartit të Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit. Rekomandohen dhe vizita në objekte ku kryhen punime për montim apo riparim të ashensorëve dhe shkallëve vetëlëvizëse.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objek të konkrete, si dhe demonstrime të proçeseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin e Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit. Atyre duhet t’iu jepen detyra praktike, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës, kabinet për realizimin e kursit.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në kabinetin e Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Montimi mekanik i ashensorit ”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MONTIMI MEKANIK I ASHENSORIT	MMA-03-20
Qëllimi i modulit	Nje modul praktik që i aftëson kursantët në montimin e udhëzuesëve të kabinës dhe kundrapeshave të ashensorit, montimin e sistemit të fuqisë që vë në lëvizje ashensorin dhe shkallën vetëlëvizëse si dhe me montimin e platformës lëvizëse.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë Modulet: “Hyrje në profesionin e Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit ” dhe “Ndërtimi i ashensorit elektrik, hidraulik dhe shkallëve vetëlëvizëse”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti monton udhëzuesin e kabinës dhe kundrapeshave. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë mënyrat e shpërndarjes së udhëzuesëve në katet e banesës të gatshme për tu montuar; - të përzgjedhë veglat, instrumentat matëse dhe të punës për montimin e shinave udhëzuese; - të kryejë të gjithë pastrimin dhe vajosjen para montimit. - të kryejë montimin e katër shinave të para dhe kontrolli i pozicionit reciprok të tyre me muret e pusit; - të kontrollojë pozicionin e tyre në lidhje me shinat dhe muret e pusit; - të kryejë montimin në të gjithë gjatësinë e pusit i të katër linjave të shinave udhëzuese dhe kontrolli i kërkesave teknike në vazhdimësi; - të përzgjedhë aksesoret që përdoren për montimin dhe fiksimin e litareve apo rripave të ashensorit; - të montojë skemën e inkastrimit të litareve (rripave) që transmetojnë lëvizjen e ashensorit; - të kryejë montimin e litarëve të ashensorit; - të kryejë montimin e kondrapeshave të ashensorit; - të mirëmbajë veglat dhe instrumentet e punës; - të realizojë kërkesat teknike dhe zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. RM 2 Kursanti monton sistemin e fuqisë që vë në lëvizje ashensorin dhe shkallën vetëlëvizëse. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :	

- të përzgjedhë veglat paisjet dhe materialet për montimin e sistemit të fuqisë së ashensorit dhe shkallëve vetëlëvizëse;
- të tregojë elementët përbërës dhe vecoritë për çdo rast të mundshëm të këtyre sistemeve;
- të tregojë gjitha rastet që përdoren për montimin e sistemit të fuqisë që vë në lëvizje ashensorin;
- të kryejë montimin e elektromotorit të vendosur në krye të shinave;
- të kryejë montimin e agregatit elektromotor – reduktor, pulexho dhe fren të vendosur në dhomën e makinerisë, kompletimi i të gjithë elementeve pjese përbërëse të kesaj dhome në ashensor;
- të kryejë montimin e sistemit të fuqisë në shkallët vetëlëvizëse;
- të demonstrojë rastet e përdorimit të më shumë se një grup fuqie të vendosur përgjatë gjatësisë së shkallës;
- të zbatojë kërkesat teknike rregullat e sigurimit teknik;
- të mirëmbajë veglat dhe instrumentet e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti monton platformën lëvizëse.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përzgjedhë veglat paisjet dhe materialet e duhura për montimin e platformës lëvizëse;
- të ndërtojë skemën e montimit të platformës lëvizëse (kasës së kabinës);
- të emërtojë pjesët përbërse të platformës lëvizëse.
- të montojë papucet udhëzuese;
- të montojë elementët e sigurisë;
- të realizojë plotësimin e kërkesave teknike të montimit të platformës lëvizëse;
- të mirëmbajnë paisjet dhe veglat e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti monton dyert e kateve dhe kabinës së ashensorit

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë elementët përbërës të një dore kati për ashensorin elektrik;
- të përzgjedhë veglat paisjet dhe materialet e duhura për montimin dhe dyerve të kateve dhe kabinës;
- të llogarisë hapjen e murit sipas dyerve të katit

- të kryejë montimit të kasës së derës - aksesorët që përdoren;
- të kryejë vendosjen e dyerve në kasë;
- të kryejë regjistrimin paraprak të dyerve në kasë;
- të përzgjedhë elementët përbërës veglat dhe kabinën e ashensorëve sipas rastit;
- të kryejë montimin e elementëve të kabinës;
- të mirëmbajë paisjet dhe veglat e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurisë gjatë montimit të një dere kati të ashensorit dhe gabinës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe mjediset e punës ose biznese që e ofrojnë këtë shërbim. - Rekomandohen dhe vizita dhe praktika në biznese që kryejnë veprimtari të Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin e Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit. Atyre duhet t’iu jepen detyra praktike, të montojnë një derë ashensori në kate duke zbatuar proceset e punës, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. - Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës, ose kabinet për realizimin e kursit. - Mjetet mbrojtëse në punë. - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në kabinetin e Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit . - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli “Montimi i paisjeve elektrike dhe elektronike të ashensorit ”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MONTIMI I PAISJEVE ELEKTRIKE DHE ELEKTRONIKE TE ASHENSORIT.	MMA-04-20
Qëllimi i modulit	Nje modul teoriko-praktik që i njeh kursantët me elementët bazë të elektricitetit dhe i aftëson në montimin e paisjeve elektrike dhe elektronike të ashensorit në gabinë.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç Ata duhet të kenë kryer Modulet: “Hyrje në profesionin e Montuesit dhe mirëmbajtësit të ashensorit ”, “Ndërtimi i ashensorit elektrik, hidraulik dhe shkallëve vetëlëvizëse” dhe “Montimi mekanik i ashensorit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë mbi elektricitetin dhe paisjet elektrike në përbërjen e ashensorit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë elementët bazë të elektricitetit; - të përshkruajë Ligjin e Omit dhe ligjin e Lencit; - të përshkruajë rrymat Alternative dhe rrymat e vazhduara si dhe fushat e përdorimit; - të përshkruajë tensionin e lartë dhe fushat e përdorimit; - të përshkruajë tensionin e ulët dhe fushat e përdorimit; - të tregojë paisjet kryesore elektrike në përbërje të ashensorit; - të tregojë destinacionin e secilës paisje elektrike në punën e ashensorit; - të përshkruajë panelin kryesor të ashensorit destinacionin dhe elementët përbërës të tij. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Pyetje - përgjigje me shkrim. RM 2 Kursanti përshkruan veçoritë e elektronikës dhe parametrat bazë të matjeve elektrike. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të përshkruajë elementët bazë të e elektroteknikës; - të përshkruajë parametrat e thjeshta elektrike ; - të tregojë madhësitë e thjeshta elektrike; - të përshkruajë nocionet bazë mbi matjet elektrike; - të përdorë njesitë matëse të parametrave elektrike;	

- të demostrojë mënyrat e matjes të parametrave elektrike;
- të përzgjedhë aparatet matëse elektrike;
- të përdorë aparatet matëse elektrike në praktikë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti kryen lidhjet e paisjeve elektrike në kabinë dhe ashensorin inverter.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur përpara fillimit të punës;
- të përshkruajë elementët përbërës ,vecoritë dhe destinacionin e një ashensori inverter;
- të kryejë lidhjen e tij me elektromotorrin;
- të kryejë lidhjen e inverterit me panelin kryesor;
- të montojë elementët elektrike në pus;
